

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIQUE DE KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No: Data: Datum: Date:
013 3	1892 09, 06, 20 17
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
 i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Datë: 9 qershor 2015

Ref. 226/013

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (*Gazeta zyrtare nr.82, 21 tetor 2010*), në nenin 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), si dhe duke u bazuar në Ligjin Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit, UA për procedurat administrative të inspektimit në institucionet edukativo-arsimore dhe shkencore, (nr. 11/2005, 4 prill 2005), Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (*Gazeta Zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011*) dhe UA 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, nxjerr:

**Urdhëresë për inspektim special të respektimit të emërtimeve të BPrAL sipas
 vendimeve për licencim**

1. Obligohet Departamenti i Inspeksionit të Arsimit që sipas Ligjit Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë (neni 2 (d), neni 4 (4.3. a), (4.3. c), (4.3. f), (4.3. m), neni 5 (5.1) dhe (5.2)), Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (neni 10 (4), neni 11, (5) dhe (6) dhe neni 14 (8)) dhe Udhëzimit Administrativ 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (neni 15 (1.2), neni 19 (1.3), neni 21 (1), (2) dhe (3) të ndërmarrë të gjitha veprimet konkrete për inspektim special të respektimit të emërtimeve të BPrAL sipas kushteve të përcaktuara në vendimet për licencim, si vijon:

- 1.1. BPrAL - Kolegji "AAB" në Prishtinë me degët në Ferizaj dhe Gjakovë, sipas vendimit për licencim nr. 8736/02-1 me datë 06.09.2013.
- 1.2. BPrAL - Kolegji "Biznesi" në Prishtinë dhe Gjakovë, sipas vendimit për licencim nr. 8593 me datë 07.10.2013.
- 1.3. BPrAL - Kolegji "Dardania" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3596 me datë 02.10.2013.

- 1.4. BPrAL - Shkolla e Lartë Profesionale "Design Factory" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3734 me datë 08.10.2013.
- 1.5. BPrAL - Kolegji "Dukagjini" në Pejë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3693 me datë 07.10.2013.
- 1.6. BPrAL - Kolegji "ESLG" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3724 me datë 02.10.2013.
- 1.7. BPrAL - Akademia "Evolucion" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3558 me datë 07.10.2013.
- 1.8. BPrAL - Kolegji "Fama" në Prishtinë me degët në Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan, sipas vendimit për licencim nr. 2/3767 me datë 02.10.2013.
- 1.9. BPrAL - Kolegji "Globus" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3800 me datë 02.10.2013.
- 1.10. BPrAL - Kolegji "Humanistika" në Ferizaj, sipas vendimit për licencim nr. 2/3993 me datë 02.10.2013.
- 1.11. BPrAL - Kolegji "ISPE" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3890 me datë 02.10.2013.
- 1.12. BPrAL - Kolegji "Juridica" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3698 me datë 08.10.2013.
- 1.13. BPrAL - Kolegji "Internacional" në Prizren, sipas vendimit për licencim nr. 3528/02-1 me datë 13.08.2013.
- 1.14. BPrAL - Kolegji "Pjetër Budi" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3583 me datë 07.10.2013.
- 1.15. BPrAL - Shkolla e Lartë Profesionale "Heimerer" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3708 me datë 02.10.2013.
- 1.16. BPrAL - Kolegji "Riinvest" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3627 me datë 07.10.2013.
- 1.17. BPrAL - Shkolla e Lartë Profesionale "Tempulli" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3584 me datë 02.10.2013.
- 1.18. BPrAL - Kolegji "UBT" në Prishtinë me kampusin në Lipjan, sipas vendimit për licencim nr. 2/3605 me datë 02.10.2013.
- 1.19. BPrAL - Kolegji "Universi" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3687 me datë 02.10.2013.
- 1.20. BPrAL - Kolegji "Universum" në Ferizaj dhe njësinë në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/3629 me datë 01.10.2013.
- 1.21. BPrAL - Kolegji "Victory" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/5374 me datë 08.10.2013.
- 1.22. BPrAL - Kolegji "Vizioni për Arsim" në Ferizaj, sipas vendimit për licencim nr. 2/3761 me datë 02.10.2013.
- 1.23. BPrAL - Kolegji "Iliria" në Prishtinë dhe dega Rezonanca, sipas vendimit për licencim nr. 2/3259 me datë 02.10.2013.
- 1.24. BPrAL - Kolegji "Gjilani" në Gjilan, sipas vendimit për licencim nr. 2/3657 me datë 02.10.2013.
- 1.25. BPrAL - "Kolegji Amerikan në Kosovë" në Prishtinë, sipas vendimit për licencim nr. 2/1025 me datë 19.03.2015.

2. Obligohet Departamenti i Inspeksionit të Arsimit që të inspektoj respektimin e emërtimeve të BPrAL sipas kushteve të përcaktuara në vendimet për licencim, në (a) të gjitha mjediset e BPrAL, (b) në dokumentacionin zyrtar të BPrAL, dhe (c) materialet promovuese të BPrAL.
3. Obligohet Departamenti i Inspeksionit të Arsimit që gjatë inspektimit special të siguroj dëshmitë materiale për shkeljet dhe parregullsitë eventuale dhe të njëjtat të bashkëlidhen raportit zyrtar për secilin BPrAL.
4. Inspeksioni i Arsimit obligohet që brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më 30 qershor 2015, të dorëzoj raportin zyrtar në të cilin konstaton gjendjen faktike dhe propozon masat për mënjanimin e shkeljeve dhe parregullsive eventuale.
5. Inspeksioni i Arsimit obligohet që në rast të konstatimit të lëshimeve dhe parregullsive, në pajtim me Ligjin Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë (neni 5, paragrafi 5.3. (e) dhe paragrafi 5.4 (c)) të marrë vendim të menjëhershëm për iniciimin e procedurës adekuate sipas shkallës së cenimit të ligjit.
6. Në rast të parregullsive apo lëshimeve të Inspeksionit të Arsimit, përgjatë procesit të inspektimit, do të merren masat e përgjegjësisë sipas Ligjit Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë (neni 6, paragrafi 6.1 (b), (c), (d), (e), (f)) dhe masat disiplinore sipas neneve 64, 65, 66, 67 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 72, 25 qershor 2010).
7. Obligohet u.d. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT dhe Drejtori i Departamentit të Inspeksionit të Arsimit në MASHT për zbatimin e kësaj urdhërese.
8. Urdhëresa hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsim BAJRAMI



Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Urdhëresa ju dërgohet:

1. u.d. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
2. Departamentit të Inspeksionit të Arsimit në MASHT;
3. Departamentit të Arsimit të Lartë në MASHT;
4. Departamentit Ligjor në MASHT;
5. Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
6. Arkivit të MASHT.